



**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**  
**DEPARTAMENTI I ORL-OKULISTIKËS**  
**KONFERENCA KOMBËTARE E SHOQATËS SHQIPËTARE E**  
**ORL-HNS**

**TEMA : PATOLOGJITË INFLAMATORE TË UNAZËS SË  
WALDAYERIT**

**PUNOI : DR. IVA DEMOLLARI      UDHËHOQI : DR. EVIS BENDO**

**TIRANË , NËNTOR 2015**

## **Abstrakt**

Semundjet inflamatore te unazes Waldeyer shfaqen me shpesh tek moshat pediatrike me infeksione te shpeshta te fytit dhe crregullime te frymemarrjes gjate gjumit.

Rreth 20 vite me pare infekzionet kronike te tonsilave ishin indikacioni kryesor per tonsilektomi.

Sot,indikacioni kryesor per adenoidektom dhe tonsilektomi eshte Crregullimet e frymemarrjes gjate gjumit(CFGJ).Ky ndyshim vjen si rezultat i evoluimit te dijes rreth impaktit qe ka CRGJ ne shendetin gjate femijerise.Nje CRGJ e patrajtuar ka impakt negativ ne cilesine e jetes se nje femije,ne sjelljen e tij si dhe ne rezultatet e tij ne shkolle.Ne menyre te ngjashme ndikojne ne shendetin e pergjithshem te femijeve edhe infekzionet kronike te tonsilave.

Femijet qe vuajne me CRGJ ankojne shpesh per dhimbje trupi,gjendje te pergjitheshme jo te mire ne krahasim me femijet e tjere.Adenoidektomia dhe tonsilektomia jane trajtimi i duhur per femijet me CFGJ dhe tonsilite kronike.Ne fokusin e kesaj teme do te jene prezantimi klinik dhe menaxhimi i semundjeve inflamatore te unazes Waldeyer.

**Fjalet kyce :** unaza Waldeyer,tonsillitis chronica,SDB(Sleep Disordered Breathing),adenoidectomy,tonsillectomy.

## **Mirënjohje**

Realizimi i këtij punimi u bë i mundur fal mbështetjes dhe udhëheqjes së cmuar të DR. Evis BENDO. Lejomëni të falenderoj gjithashtu, të gjithë stafin e SHQATËS SHQIPËTARE TË ORL-HNS, duke filluar nga PRESIDENTI i Shoqatës, Prof. Asoc. Dr Suela SALLAVACI, për punën e tyre të palodhur.

**JU FALEMNDERIT !**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1.HYRJE.....</b>	<b>4</b>
<b>2.ANATOMIA DHE EMBRIOLOGJIA.....</b>	<b>5</b>
<b>3.IMUNOFIZIOLOGJIA.....</b>	<b>7</b>
<b>4.PREZANTIMI KLINIK.....</b>	<b>7</b>
<b>5.INFEKSIONET.....</b>	<b>8</b>
<b>5.1 Viruset.....</b>	<b>8</b>
<b>5.2 Bakteriologjia/Mikrobiologjia.....</b>	<b>8</b>
<b>6. HIPERTROFIA.....</b>	<b>9</b>
<b>7.VLERESIMI KLINIK.....</b>	<b>10</b>
<b>7.1 Adenoidet.....</b>	<b>10</b>
<b>7.2 Tonsilat.....</b>	<b>10</b>
<b>7.3 Abcesi peritonsilar (APT).....</b>	<b>11</b>
<b>8. MENAXHIMI.....</b>	<b>11</b>
<b>8.1 Infeksion/Inflamacion.....</b>	<b>11</b>
<b>9. SDB(Sleep Disorders Breathing).....</b>	<b>13</b>
<b>10.TEKNIKAT KIRURGJIKALE.....</b>	<b>14</b>
<b>10.1 Tonsillectomi.....</b>	<b>14</b>
<b>10.2 Adenoidectomi.....</b>	<b>15</b>
<b>11 REZULTATET.....</b>	<b>15</b>
<b>11.1 Cilesia e jetes.....</b>	<b>15</b>
<b>12.KUNDERINDIKIMET.....</b>	<b>15</b>
<b>13.KOMPLIKACIONET.....</b>	<b>15</b>
<b>14. DEBATET/POLEMIKAT.....</b>	<b>17</b>
<b>15.CLINICAL PRACTICE GUIDELINE.....</b>	<b>18</b>
<b>16. KONKLUZIONET.....</b>	<b>20</b>
<b>17. LITERATURA.....</b>	<b>22</b>

## Hyrje

Ne fillimin dhe mesin e shek.XX , adenoidektomia dhe tonsilektomia ishin procedurat me te shpeshta kirurgjikale ne SHBA dhe si indikacion kryesor per kryrjen e tyre ishin tonsilitet kronike.Si pasoje e nje reagimi te ashper publik dhe hetimi mbi indikacionet e paskrupullta dhe te paprovuar per efekshmerin e tyre per adenotonsilektomi,ne fund te viteve 1970 dhe fillim te viteve 1980 pati nje renie me 50% deri 70% te ketyre nderhyrjeve kirurgjikale.Megjithate qe atehere frekuencia e adenotonsilektomive eshte dyfishuar serisht,kjo si pasoje e CFGJ ( cregullimet e frymemarrjes gjate gjumit),incidencia e se ciles arrin pikun ne femijerine e hershme dhe prek 1% deri ne 4% te femijeve.<sup>1</sup>

## Anatomia dhe embriologja

**Unaza e Waldayer-it** eshte mje strukture unazore e indit limfoid me vendosje ne orofaring dhe nazofaring.

Ajo formohet nga :

- 1) tonsilat palatine
- 2) adenoidet
- 3) tonsilat linguale
- 4) tonsilat tubare

Ky ind limfoid permbar limfocite B,limfocite T, plazmocite dhe luan rol te rendesishem ne imunitetin sekretor.

**Adenoidet** qe njihen si tonsilat faringeale, zhvillohen fare prane gjendrave te shtreses mukozale, pergjate murit posterior dhe superior te nazofaringut.Struktura baze e adenoidit perbehet nga pala dhe plika te cekta te vodosura ne menyre sagitale, te mbuluara me epithelium respirator.

Folikuj limfoid zhvillohen perreth kripteve dhe dukteve te glandulave.Kriptet fillojne te formohen ne muajin e 3 te shtatezanise.

Adenoidet rriten deri ne vitin e 6-7 te jetes dhe me pas fillojne te atrofizohen deri ne pubertetin e hershem. Furnizohen me gjak nga dega faringeale e a.karotide eksterne dhe disa dege te a.maksilare interne dhe a.faciale.Inervimi behet nga n.glosofaringeus dhe n.vagus.Forma e adenoidit eshte e ngjashme me nje piramide,maja e te ciles drejtohet drejt septumit nazal ndersa baza vodoset mbi murin posterior te nazofaringut.

**Tonsilat palatine** rrjedhin nga pjesa ventrale e endodermes e xhepit te dyte faringeal.Ky epitel invaginon dhe formon degezime se bashku me mezenkimen duke formuar kriptet karakteristike.Kapsula e tonsilave palatine formohet nga kondesimi i mezenkimes.Ne ndryshim nga adenoidi,tonsilat palatine vishen me epitel skuamoz.Limfocitet popullojne

---

<sup>1</sup> Rosenfeld RM, Green RP. Tonsillectomy and adenoidectomy: changing trends. Ann Owl Rhinol Laryngol 1990;99 :187-191.

Erickson BK. Larson DR. St Sauver JL. et al. Changes in incidence and indications of tonsillectomy and adenotonsillectomy, 1970- 2005. Owlaryngol Head Neck Surg 2009;140:894-901.

tonsilat palatine ne muajin e 3 te shtatezanise,duke formuar nodujt limfatik.Proliferimi dhe maturimi i limfociteve behet ne mezenkimen perreth. Organizimi limfoid perfundimtar perreth kripteve vihet re ne tremujorin e fundit te shtatzanise. Tonsilat palatine gjenden ne hyrjen e orofaringut,ndermjet m.palatoglosus ose harkut te perparem palatin dhe m.palatofaringeus ose harkut te pasem palatin.Fascia e muskulit faringeal konstriktor superior sherben si kufiri lateral i foses tonsilare.Tonsilat palatine jane te vetmet tonsila qe kane kapsul dhe me permasa me te medha nga tonsilat e unazes Waldeyer. Kapsula tonsilare eshte nje pjese speciale e fascies faringobazilare qe vesh nje pjese te tonsilave palatine dhe shtrihet drejt indit tonsilar duke shoqueruar enet e gjakut dhe nervat.Kjo kapsul aderon me fasciet prane me ind lidhor kryesisht avaskular,i cili shfrytezohet gjate tonsilektomise.Ne rastet kur hipertrofia tonsilare shtrihet deri ne rrenjen e gjuhes duke u bashkuar me tonsilat linguale,n.glosofaringeus dhe sidomos dega linguale,e cila ne  $\frac{1}{4}$  e rasteve gjendet ngjitur me kapsulen mund te demtohet gjate tonsilektomise dhe si pasoje pacienti te kete dhimbje.Furnizimi me gjak i tonsilave palatine eshte i ndryshem,por ne per gjithesi behet nga disa dege te a.karotis eksterne si : a.faringeale ascendente,a.palatine ascendente si dhe dege nga a.linguale dhe a.faciale.Furnizimi me gjak behet permes polit inferior te tonsiles palatine.A.karotide interne gjendet rrerh 2-2.5 cm me thelle,posteriorolateralisht tonsiles palatine.Ne disa raste a.karotide interne mund te gjendet me prane rrerh 1 cm distance nga poli inferior.A.karotide interne mund te kete nje kurs tortuz dhe te nderlikuar.Drenimi venoz behet permes pleksit venoz tonsilar qe mbeshtjell kapsulen,e prej andej ne v.linguale dhe v.faringeale.Drenimi limfatik behet fillimisht ne limfonodujt cervical dhe jugular te thelle,te cilet mund te behen te dhimbshem dhe te inflamohen gjate infeksioneve tonsilare.Inervimi behet nga dege te n. glosofaringeus dhe dege te n. palatin minor permes ganglionit sfenopalatin.Struktura histologjike e tonsilave eshte e lidhur ngushte me funksionin e saj si nje organ imunologjik.Epiteli i kripteve mundeson kalimin e antigeneve te inhaluara apo te gelltitura per ne indin limfatik te tonsilave.Keto kripte jane te mbushura me limfocite prezantuese te antigeneve, te cilat i`ua prezantojne antigenin qelizave limfocite imunologjikisht aktive ne stromen tonsilare.

**Tonsilat linguale** zhvillohen ne regionin posterior te bazes se gjuhes.Kjo zone eshte e mbuluar me glandula mukozale, te cilat popullohen me qeliza limfoide rrerh muajit te 5-te te shtatzanise.Kriptet e tonsilave linguale shfaqen ne lindje dhe jane me te cekta dhe me pak te komplikuar se ato te tonsilave palatine.

**Tonsilat tubare** vendosen ne pjesen laterale te nazofaringut,perreth ostiumeve te tubave te Eustakit.Indi limfoid i tyre mbullohet me epitel respirator me cilie.Nuk kane kapsul dhe kane pak kripte.

## Imunofiziologjia

Adenoidet dhe tonsilat luajne nje rol te integruar ne mbrojtjen e organizmit dhe ne vecanti te traktit aerodigestiv nga antigen te ndryshem.Per shkak se adenoidet dhe tonsilat nuk kane kanale limfatike aferente si indet limfoide sekondare,ato jane te veshura

ne siperfaqe me epitel.Kriptet e tonsilave rrisin siperfaqen e kontaktit me antigenet e gelltitur ose te inhaluar. Keto kripte jane te rrethuara me aggregate te mediatoreve qelizor te sisitemit imun. Limfocitet B,sasi me te vogla te limfociteve T si dhe qeliza te ndryshme prezantuese te antigeneve (makrofage,qeliza dentritike) gjenden ne sasi te bollshme ne indin subepitelial te tonsilave. Keto inde analizojne stimujt antigenik lokal,i shkaterrojne ato dhe prodhojne qeliza efektive dhe te kujteses, te cilat perhapen ne pjese te tjera te mukozes. Ato sherbejne si nje njesi induktive per perjigjen me antikorpe lokale dhe ne distance dhe prodhojne kujtese imunologjike te pavarur nga sistemi imun sistemik.Ky funksion eshte me i shprehur gjate femijerise dhe me kalimin e viteve zbehet.

Mikroskopikisht adenoidet kane 3 lloje epiteli: cilindrik pseudoshtresor me cilie,skuamoz shtresor dhe epitel trazicional. Infekzionet kronike te adenoideve bejne qe te mbizoteroi epiteli skuamoz shtresor.

Duke ditur rolin ne mbrojtjen imunologjike disa kane ngritur pyetje mbi efektin qe kane nderhyrjet kirurgjikale si adenotonsilektomite ne integritetin imunologjik. Rezultatet e shume studimeve tregojne se nderhyrjet e mesiperme nuk kompromentojne sistemin imun te femijeve.Eshte vene re se imuniteti i femijeve pas adenotonsilektomive rikuperohet njesoj si perpara se te kryhej nderhyrja dhe nuk ndikohet nese nderhyrja behet ne femijerine e hershme apo ne adoleshence.

## Prezantimi klinik

Semundjet adenotonsilare mund te jene infektive,obstruktive ose te dyja se bashku. Procesi patologjik mund te prek adenoidin,tonsilat ose te dyja njekoheshish.

## Infekzionet

### Virusale

Viruset luajne rol te rendesishem ne fillimin e ndryshimeve inflamatore te mukozes,obstrukcionin e kripteve duke krijuar kushte per vendosjen e nje mbiinfekzioni bakterial. Prezantimi klinik i tonsilosaringitit viral eshte i ngjashem me infekzionin bakterial,por simptomat jane me te lehta.

Ketu perfshihen :

- a) dhembje fytit
- b) odinofagia
- c) otalgia
- d) dhimbje koke
- e) temperature.

Gjithashtu vihet re eriteme e tonsilave,hipertrofi e tyre me ose pa eksudat ne siperfaqe. Viruset shkaktare jane te njejte me ato te semundjeve te siperme respiratore si :

**Rhinovirus, Koronavirus, Adenovirus, Herpes simplex virus, Parainfluenca virus, Epstein Barr virus dhe Cytomegalovirus.**

**Herpangina** shkaktohet nga coxsackievirus. Prek kryesisht femijet e vegjel. Karakterizohet nga vezikula te vogla, qe mund te ulcerohen dhe qe vendosen ne nje terren eritematoz, ne harkun palatin anterior, palatum mole dhe murin e pasem te faringut. **Infekzionet akute nga Epstein Barr virus** mund te prezantohen si tosillofaringite, me dhimbje fyt, temperature, hipertrofi te shprehur tonsilare, limfadenopati difuze cervikale, petekie ne palatum dhe gjendje te per gjitheshme jo te mire. Diagnoza konfirmohet nepermjet klinikes, mbi 10% limfocite atipike ne gjakun periferik dhe nje test monospot pozitiv (antikorpe heterofile).<sup>2</sup>

### Bakteriale/Mikrobiale

Cdo diskutim per semundjet infektive adenotonsilare duhet te marre parasysh disa observime te rendesishme:

**Se pari** shume infeksione mund te jene te lidhur me pranine e organizmave prodhues te enzimes beta-laktamaze, te cilet ndryshojne floren bakteriale normale te traktit aerodigestiv duke e kthyer ate ne patogjene.

**Se dyti** infekzionet shpesh kane natyre polimikrobiale duke perfshire edhe patogen anaerob.

**Se treti** obstruksioni i kripteve tonsilare mund te sherbeje si nje fole per stazeni bakteriale, e cila mund te shkaktoje nje infeksion kronik, supuracion dhe fistula.

Studimet bakteriologjike te kryera ne mostrat e adenoideve te marra pas operacioneve demostruan prezencen e disa specieve aerobike : Streptokoku alpha dhe gamma hemolitik, Hemofilus influence, Stafilocoku aureus, Streptokoku beta hemolitik grup A dhe Moraxella cataralis. Organizmat anaerob qe u vune re ishin Peptostreptokokus, Provtella dhe Fusiobacterium. Rezultate te ngjashme jane vene re ne mostra te marra nga indet tonsilare. Si pasoje kulturat siperfaqesore kane nje rol te vogel per percaktimin e organizmit patogen sidomos ne infekzionet kronike. Ne per gjithesi shumica e autoreve i atribuojne rreth 15-30% te rasteve te tonsilofaringiteve streptokokut beta-hemolitik grup A. Ne rastet e tjera perfshihen Streptokoku beta-hemolitik grup C, Neisseria gonorrhoeae, Corynobacterium diphtheria, Chlamydia pneumonia. Studimet kane treguar qe eksudatet ne tonsilofaringite dhe limfadenitet cervikal anterior ka shume te ngjare te shkaktohen nga Streptokoku beta-hemolitik grup A. Kroniciteti i semundjeve adenotonsilare i atribuohet mbivendosjes se infeksioneve qe shkaktohen nga organizma te shumte patogen qe formojne fistula, xhepa ne parenkimen tonsilare me permbajtje purulente edhe ne mungese te shenjave klinike.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Richtsmeier WJ. Human interferon production in tonsil and ade- noid tissue cultures. *Am J Owlaryngol* 1983;4:325-333.

<sup>3</sup> Richtsmeier WJ. Human interferon production in tonsil and ade- noid tissue cultures. *Am J Owlaryngol* 1983;4:325-333.

## Hipertrofia

Megjithese ne gjejme ndryshime ne prezantimin klinik te semundjeve infektive nga ato hipertrofike,eshte e vertete qe shumica e hipertrofive adenotonsilare jane pasoje e infeksioneve kronike qe prekin keto inde.Studimet mbeshtesin etiologjine bakteriale te hipertrofise tonsilare.Disa autore argumentojne se, si shkak etiologjik i hipertrofive tonsilare tek femijet eshte *Hemophilus influence*.Hiperplazia e adenoideve eshte vene re se eshte proporcionale me numrin e limfociteve dhe ngarkesen bakteriale te indit te adenoideve.

**Hipertrofia e adenoideve** eshte nje shkak i shpesht i obstruksionit nazal tek femijet e vegjel.

Ai mund te prezantohet :

- a) me rrjedhje rekurente ose kronike nga hundet
- b) gerrhitje
- c) CFGJ
- d) otite media rekurent
- e) disfunksione te tubit te Eustakit

Ne ekzaminimin fizik vihet re histori per frymemarje me goje,ze hiponazal dhe facies adenoid,i cili karekterizohet nga nje buze e holle,hark dentar i siperm i ngushte,rritje e gjatesise anteriore te fytyres,kend i ngushte mandibular dhe mandibul retrognatike.Keto ndryshime ndodhin si pasoje e pozicionit te gjuhes dhe te kokes,te balances muskulare sekondare si pasoje e frymemarjes me goje hapur qe pason obstruksionin nazal.

**Hipertrofia tonsilare** karakterizohet :

- a) disfagia
- b) CFGJ
- c) ndryshim te zerit
- d) malokluzione dentare

Femijet shpesh ankojne per veshtersi ne kalimin e ushqimit si dhe per nje ndjenje te “gojes se mbushur plot”.

Prania e nje tonsile hipertrofike te vetme shkon per infekzion ose patologji malinje te tonsiles.Nje rritje e papritur e indeve limfoide te unazes Waldeyer rrit dyshimet per nje limfome.Infeksione nga *Mykobakterium atipik*,*Actinomycosis* dhe semundje limfoproliferative ne femijet qe i jane nenshtruar transplanteve te organeve solide duhet te merren parasysh kur ka rritje te njeaneshme te tonsilave.<sup>4</sup>

## Vleresimi klinik

### Adenoidet

Hiperplazia obstruktive nga adenoidet diagnostikohet nepermjet vleresimit klinik.Frymemarja me goje,ngjirrja e zerit dhe e folura hundore jane ankesat qe shfaqen

---

<sup>4</sup> Guillemainault C, Lee JH, Chan A Pediatric obstructive sleep apnea syndrome. *An:h Pediatr Adolesc Med* 2005;159:775-785.

me shpesh.Rhinorrhea,rrjedhja posnazale dhe kolla kronike jane te zakoneshme por jo specifike.Facies adenoid mund te jete gjithashtu i pranishem.Diagnoza diferenciale ndermjet infeksioneve akute dhe kronike me semundjet sinonazale eshte shpesh e veshtire.Shpesh adenoiditet akute dhe kronike diagnostikohen si sinuzite.Shume femije te moshes nen 6 vjec kane permiresim te symptomave pas adenoidektomise.Prinderit duhet te tregojne kujdes qe nese edhe pas adenoidektomise simptomat nuk kalojne,ata duhet te shkojne serisht tek mjeku ne menyre qe te shihet per mundesine e semundjeve sinonazale.Nje ekzaminim minimal qe mund te kryhet tek nje femije qe bashkepunon eshte rhinoskopia anteriore.Ky ekzaminim do i mundesonte mjekut te dalloj shkaqet e ndryshme te obstruksionit nazal si hipertrofia e konkave nazale,edema e mukozez nazale apo ndonje trup i huaj ne kavitetin nazal dhe te diferencoj keto shkaqe nga ato te nazofaringut.

Ekzaminimi i adenoideve shpesh eshte i veshtire tek femijet qe nuk bashkepunojne.Tek keto raste mund te kryhet radiografi laterale e kokes.Keto jane ekzaminime ndihmese te ekzaminimit klinik dhe te anamnezese.Se fundi,gjithmone e me teper po kryhet nazofaringoskopia per ekzaminimin e femijeve.Ky ekzaminim mundeson te shihen adenoidet ne menyre direkte pa marre rrezatim.Nazofaringoskopia ofron nje pamje mjaft te mire te adenoideve dhe strukturave perreth.Metoda te tjera sic eshte videofluoroskopia na japing te dhena per permasat e adenoideve por pacientet marrin rrezatim te tepert.<sup>5</sup>

## Tonsilat

Per ekzaminimin e tonsilave kryejme orofaringoskopia.Me ndihmen e nje spatule mbahet gjuha e ulur ne dyshemene e gojes.Refleksi i te vjelles dhe nxjerra e gjuhes jashte bejne qe tonsilat te afrohen me medialisht dhe te duken me te medhaja.Kur femija ben “aaah” ne mund te vleresojme integriteten dhe levizjen e palatumit.

Klasifikimi i tonsilave sipas permasave eshte:

- Grade 1 (0-25% obstruksion respirator)
- Grade 2 (25-50% obstruksion respirator)
- Grade 3 (50-75% obstruksion respirator)
- Grade 4 (75-100% obstruksion respirator)

Me marrveshje shenohen 1+,2+,3+,4+.

Femijet qe kane risk me te larte qe te bejne CFGJ si pasoje e hipertrofise tonsilare jane femijet me sindromin Down, me anomali kraniofaciale, obezitet dhe semundje te SNQ.Keta femije mund te kene simptoma pavaresisht shenjave klinike apo madhesise se tonsilave.<sup>6</sup>

## Abcesi peritonsilar(APT)

---

<sup>5</sup> Mattila PS, Thhkokallio O, Tarkkanen J, et al. Causes of tonsil- lar disease and frequency of tonsillectomy operations. *An:h Owlaryngol Head Neck Surg* 2001;127:37-44.

<sup>6</sup> Guillemainault C, Lee JH, Chan A Pediatric obstructive sleep apnea syndrome. *An:h Pediatr Adolesc Med* 2005;159:775-785.

APT-ja eshte komplikacioni me i shpeshte.Ai mund te vije si pasoje e perhapjes se infekcionit nga parenkima tonsilare por ne menyre sekondare edhe nga glandulat e vogla salivare(glandulat e Weberit) ,qe gjenden mbi polin e siperme te tonsilave.Abcesi formohet midis kapsules tonsilare dhe muskujve te siperme konstriktor ne pjesen laterale te foses tonsilare.Ne disa raste abcesi mund te kaloj fascien dhe te vendoset ne regionin parafaringeal.Incidencia e tyre eshte 30 paciente ne 100.000 cdo vit.Ai eshte i shpeshte tek femijet mbi 12 vjec,por eshte gjendur ne cdo moshe.Ashtu si edhe tonsilosfaringitet streptokoksike edhe APT jane te shpeshte ne vjeshte dhe ne dimer.Prezantimi klinik tipik i tij eshte me dhimbje te forte ftyi, zerin”patate e nxehte”,temperature,trismus,disfagi dhe gjendje te perjitheshme jo te mire.Limfadenopatia e dhimbshme dhe dhimbja e veshit mund te jene gjithashtu te pranishme.Ekzaminimi fizik zbulon zhvendosje mediale dhe inferiore te tonsiles se prekur,fshehje te saj si dhe zhvendosje te uvules drejt tonsiles tjeter.Diagnoza eshte klinike por mund te perdoret edhe ultrasonografia intra orale.CT scan eshte ekzaminimi i duhur per vendosjen e diagnoses tek femijet qe nuk bashkepunojne.Femijet me te vegjel se 5 vjec me hapje te vogel te gojes,temperature,dhimbje,disfagi dhe trismus duhet te dyshohen per APT.Trajtimi eshte incizioni dhe drenimi i abcesi.Tek femijet qe bashkepunojne nderhyrja mund te kryhet ne ane te krevatit me anestezi lokale.Edhe tek femijet qe nuk bashkepunojne,sedacioni intravenoz ne dhomen e urgjences mund te ndihmoj ne drenimin e abcesit ne menyre qe femija te mos cohet ne sallen e operacionit.Trajtimi kerkon gjithashtu rihidrim intravenoz,mbulim me antibiotike kunder stafilokokut si dhe analgjezik.Nga ana tjeter nese femija do futet ne sallen e operacionit dhe do i nenshtrohet anestezise se perjitheshme atehere tonsilektomia eshte zgjidhja me e mire ne rastin e APT dhe abcesit parafaringeal.

## Menaxhimi

### Infekzion/inflamacion

Menaxhimi i nje femije me semundje adenotonsilare varet nga etiologja dhe perfshin trajtimin me medikamente dhe ate kirurgjikal.

**Infekzionet akute** kane nevoje per antibiotike te pershtateshem dhe per kontrollin e simptomave klinike.Megjithate shumica e semundjeve adenotonsilare te perseritura konsiderohen si problem kirurgjikal.

Ne nje studim qe eshte bere ne lidhje me efektin e terapise me steroid inhalator ne hipertrofine e adenoideve eshte vene re nje perfitim i vogel per nje kohe te shkurter.Tonsilitis akut mund te menaxhohet duke bere kerkimin per streptantigenin e shpejte si dhe kulturen e fytit per nje diagnoze definitive.Strepantigeni i shpejte ka nje sensitivitet 72-92% dhe specificitet 89-96%.Bakteri me i shpeshte shkaktues i tonsilosfaringitit eshte streptokoku beta hemolitik me 37% te rasteve.Fatmiresisht grapi A i streptokokeve vazhdojne te jene te ndjeshem ndaj penicilines.Megjithese ka nje mbizoterim te

mikroorganizmave prodhues te beta laktamazes te cilet shkaktojne edhe hipertrofine tonsilare.

Antibiotiket jane pare qe sjellin perfitime modeste ne dhimbjet e fytit duke shkurtuar ditet me simptoma .Sic eshte diskutuar edhe me siper,eshte bere nje paralajmerim per kujdesin e trajtimit me antibiotike te mononukleozes infective.Femijet qe dyshohen per mononukleoze nuk duhen trajtuar me ampiciline apo amoxiciline pasi mund te shkaktojne rash kutan.

Ne rastet kur edema e shpejt e adenoideve dhe e tonsilave con ne nje obstruksion te menjehereshem respirator,administrimi intravenoz i steroideve eshte menyra me e mire per nje clirim te shpejte te rrugeve te siperme respiratore.Kur dyshohet per infektion bakterial niset mjekimi me antibiotik.Rralle here rekomandohet te kryhet adenotonsilektomia ne fazen akute te infektionit.

Ne vitin 2011 Akademia Amerikane e Otolaringologjise publikoi nje udherrefyes te praktikes klinike per indikimet e tonsilektomise,te bazuar ne nje rishikim te gjere te literaturove nga ekspert otolaringolog dhe jo otolaringolog.Ata nxorren ne pah se indikimet me te shpeshta ishin tonsilitis rekurrent dhe CFGJ,te cilat jane te permblehdhura ne fund te temes.

Ne lidhje me **tonsilitet rekurrente** rekomandohet te vleresohen sipas kritereve “Paradise”, se cilet femije mund te perfitojne nga tonsilektomia.Ata rekomandojne mbajtjen nen vezhgim te femijeve qe nuk bejne 7 episode tonsiliti ne viti, 5 episode cdo vit per dy vitet e shkuara ose 3 episode cdo vit per tre vitet e shkuara. Ky rekomandim eshtë mbeshtetur ne literaturen e posacme duke bere krahasimin e rreziqeve dhe perfitimeve te interventit me mbajtjen nen vezhgim te pacientit.

Studimi “The Paradise” dhe studimet e mevonshme kane treguar se perfitime me te medha jane arritur ne femijet te cilet jane prekur ne menyre sinjifikante nga tonsillitet ne krahasim me ata me tonsilitis te moderuar.Megjithate edhe ata qe plotesojne kriteret duhet te keshillohen per perfitime modeste te pritura,riskun e komplikacioneve nga tonsilektomia ne krahasim me sherimin natyral.Panel i studiuesve sugeron se nuk ka nje epersi te madhe te perfitimeve ne krahasim me demtimet ne rastin e tonsilektomise kur si indikacion eshte tonsilitis rekurrent .

Kushtet që duhet të plotësohen për t'u konsideruar një episod diskret tonsiliti dhe jo thjesht faringit apo infektion traktit të sipërm respirator janë :

- a) temperaturën më të madhe se  $38.3^{\circ}\text{C}$
- b) adenopati te qafës
- c) eksudat tonsillar
- d) test pozitiv për SBH

Rekomandohet tonsilektomia per etiologji infektive kur ka indikacione të tjera bindese :

- a) si reaksione apo intolerancë nga antibiotiket
- b) ESFA (ethe periodik, stomatit aftoz, faringit, dhe adenitis te qafës )
- c) histori per absces peritonsillar
- d) historitë e sëmundjeve reumatike të zemrës ose glomerulonefriti

Vendimet për të kryer tonsilektomine për indikacione si :

- a) halitosis
- b) tonsilitet kronike
- c) maloklusion
- d) tonsilat me kripte
- e) ngarkesen kronike me SBH

nuk rekomandohen si te domosdoshme ose perfituese nga tonsilektomia e bazuar kjo ne literature e sotme.<sup>7</sup>

**Tab.1 Kriteret Paradis per tonsilektomi**

Kriteret	Pershkrimi
<b>Dhembe ftyi me frekuence minimale</b>	7 ose me shume episode ne vit ose 5 ose me shume cdo vit per dy vitet e kaluara ose 3 episode cdo vit per tre vite.
<b>Karakteristika klinike</b>	Temperatura $>38.3$ C ose limfadenopati cervikale ose eksudat tonsilar ose kulure positive per SBH
<b>Trajtimi</b>	Antibiotike ne doza te pershtateshme
<b>Dokumentime</b>	Cdo episod i dokumentuar ose nese nuk jane te dokumentuar behet nje observim 12 mujor

### **Crregullimet e frymemarrjes gjate gjumit(CFGJ)**

Ajo qe ka treguar perfitim te mire dhe permiresim te shendetit eshte perdonimi i tonsilektomise ne menaxhimin e CFGJ-se.

CFGJ karakterizohet nga obstruksione parciiale ose komplete rekurrente te rrugeve te siperme respiratore gjate gjumit.Gerrhitja as e perjashton e as e verteton CFGJ,por eshte vene re qe tek femijet eshte e shpeshte.CFGJ eshte nje semundje multifaktoriale,e cila zhvillohet ne prani te nje kombinimi anatomic,toni neuromuskular dhe hipertrofise adenotonsilare.Keshtu qe disa femije qe vuajne me CFGJ nuk kane hipertrofi

<sup>7</sup> Mattila PS, Thhkokallio O, Tarkkanen J, et al. Causes of tonsil- lar disease and frequency of tonsillectomy operations. *An:h Owlaryngol Head Neck Surg* 2001;127:37-44.

adenotonsilare.Gjithashtu eshte e njojur qe madhesia e tonsilave nuk eshte e lidhur me CFGJ.

Hipertrofia e adenoideve,e tonsilave apo e te dyjave sebashku mund te shkaktojne obstruksion te rrugeve te siperme respiratore,i cili shkakton hipoventilim alveolar deri ne cor pulmonar.Eshte vene re se CFGJ shpesh shkakton tek femijet simptomat e CDVH(Crregullimi i Deficitit te Vemendjes dhe Hiperaktiviteti).Femijet me CFGJ mund te kene enuresis nokturna, probleme te sjelljes, performance te dobet ne shkolle, kualitet te ulet te jetes dhe probleme me rritjen.

Megjithese polisomnografia eshte standarti i art per diagnozen e CFGJ,ajo nuk eshte e domosdoshme te kryhet tek te gjithe femijet.Per femijet e shendetshem me prezantimin tipik te CFGJ : pergiumje gjate dites,enuresis nokturna,probleme te sjelljes,performance te dobet njoheze,hipertrofi adenotonsilare me ose pa apnea te gjumit te deshmuara eshte e arsyeshme te procedohet me adenotonsilektomi pa bere polisomnografine.Ne disa raste polisomnografia preoperative eshte e nevojshme si psh ne rastin e femijeve qe vuajne edhe nga semundje te tjera,me te vegjel se 3 vjec,pa hipertrofi adenotonsilare ose kur gjetjet klinike nuk jane ne perputhje ne obstruksionin e rrugeve te siperme respiratore.<sup>8</sup> CFGJ mund te persistoj ose te perseritet pas adenotonsilektomise dhe mund te kerkoj nderhyrje te tjera,si psh presione positive te vazhdueshme ajri.Familjaret duhet te jene ne dijeni te mundesive dhe rezultateve perfundimtare perpara interventit.Asimetria tonsilare nuk perben nje indikacion per tonsilektomi.Asimetria tonsilare ne mungese te simptomave te tjera te malinjitetit duhet te mbahet ne vezhgim.Ne rast se ka dyshim klinik per limfome atehere kirurgu ne bashkepunim me onkologun vendos te marr moster per biopsi.

Nje anamneze e kujdeshme duhet te merret per histori hemoragjie te pacientit dhe familjare si dhe per marrjen e ndonje medikamenti qe ndikon ne rritjen e kohes se hemoragjise.Studimet tregojne se perdonimi rutin i testeve te koagulimit ka rendesi te vogel dhe ka nje sinjifikance te vogel prognostike per hemoragjine posttonsilektomi.

## Teknikat kirurgjikale

### Tonsilektomia

Pershkrimi i pare i tonsilektomise eshte bere nga C.Celsus.Procedura ka ardhur duke u permiresuar dhe persosur me kalimin e viteve.Megjithe persosjen e teknikes,kirurget nuk kane mundur te ndryshojne semundshmerine dhe vdekshmerine e kesaj procedure.Ne dy dekadat e fundit jane bere shume studime per menyren se si te ulet semundshmeria dhe te zvogelohet koha e rimekembjes pas procedures.

Heqja e tonsilave se bashku me kapsulen e tyre e ka originen ne SHBA ne shek.XX.Plaqa operatore lihet te mbyllte per secundum.Kjo eshte unike dhe nuk ndodh ne asnje procedure tjeter kirurgjikale.

---

<sup>8</sup> Mitchell RB, Kelly J, life in children with sleep-disordered breathing. *Int J Pediatr Otorhinolaryngol* 2006;70:395-406.

Prej 1980 elektrokauteri eshte bere nje paisje e zgjedhjes se pare ne tonsilektomi nga kirurget.Ai eshte i lehte per tu perdorur dhe redukton sasine e gjakut te humbur gjate procedures.Duke u bazuar ne observimet e anetareve te Akademise Amerikane te Otorinolaringologeve dhe te Shoqates Amerikane te Pediater

Otorinolaringologeve,elektrokauteri eshte metoda me e pelqyer per tonsilektomi nga 55% e otorinolaringologeve,koblation tonsilektomi nga 20%-25% e tyre,teknika e ftohte nga 10% e tyre dhe tonsilektomia e pjeseshme me mikrodebrider rrreth 10%.Teknikat e tjera perfshijne lazerin,kauterin bipolar, reduktimin me radiofrekuence dhe bisturin ultrasonik. Se fundi ka nje rritje te interesimit per heqjen parciiale te tonsilave apo tonsilotomine,qe ruan kapsulen tonsilare dhe redukton dhimbjen dhe hemoragjin post tonsilektomi.Nga studimet qe jane bere eshte vene re se rrreth 0.5%-6% te rasteve ka nje rirritje te tonsilave pas tonsilotomise.Roli i teknikes intrakapsulare ne rastet e femijeve me tonsilite rekurente nuk eshte ende i provuar.

Te gjitha metodat perfshijne identifikimin e kufinjeve tonsilar,ruajtjen e strukturae anatomike dhe hemostazën e perpikte.Kirurgu duhet te jete gjithmone i kujdeshem per demtimet qe shkakton kauteri,si djegjet e komisures orale dhe te lekures.<sup>9</sup>

### **Adenoidektomia**

Ne te shkuaren per adenoidektomi perdoresh kyrete adenoidi apo sic quhet ndryshe adenotom.Per hemostaze perdoreshin garza dhe agjent topik si : bismuth,acid tanik si dhe oxymethasolin.Shqetesimet dhe komplikacionet e kesaj teknike perqendrohen ne hemoragjine e tepert dhe sidomos ne mbetjet e indit te adenoidit rrreth ostiumit te tubit te Eustakit dhe koaneve posterior.Suction Bovie cautery,microdebrider dhe coblation jane ne ditet e sotme te perdonura gjeresisht per heqjen e adenoideve.Ato kane rezultuar mjaft efektive,eficente dhe ralizojne nje hemostaze te mire.Disavantazhi i tyre eshte kostoja e larte.

---

<sup>9</sup> Cullen KA. Hall MJ, Golosinskiy A Ambulatory surgery in the United States, 2006.*Nat! Health Stat Report* 2009:1-25.

Derkay CS. Pediatric otolaryngology procedures in the United States: 1977-1987.*Int'l Pediatr Otolaryngol* 1993;25:1-12.

## **Rezultatet**

### **Cilesia e jetes**

Studime e bera kane treguar se CFGJ prek ne menyre te ngjashme cilesine e jetes se femijeve si edhe artriti reumatik juvenile. Ne shume studime eshte vene re roli shume i madh i adenotonsilektomise ne permiresimin e cilesise se jetes tek femijet me CFGJ. Permiresimet jane vene re qe ne 6 mujorin e pare pas nderhyrjes. Shkalla e perfitimit eshte ne varesi te CFGJ-se, sa me e madhe ajo aq me shume perfitim pas adenotonsilektomise do te kete. Gjithashtu eshte vene re qe femijet obez kane me pak perfitim nga nderhyrja ne krahasim me femijet jo obez. Edhe tek femijet me tonsillitis recurrent eshte vene re nga studimet nje permiresim i cilesise se jetes.<sup>10</sup>

### **Kunderindikimet**

Kunderindikime per kryerjen e tonsillectomies jane anomalite e koagulimit. Gjithashtu femijet me semundje akute te cilet si pasoje e gjendjes jo te mire nuk duhet ti nenshtrohen anestezise se per gjitheshme.<sup>11</sup>

### **Komplikacionet**

Megjithese mendohet nga te gjithe se tonsilektomia eshte nje procedure e lehte, ajo nuk eshte e tillë. Tonsilektomia mund te shoqerohet me shume komplikacione qe kerkojne hospitalizim. Komplikacioni me i shpeshte dhe me i rendesishem eshte hemoragja

---

<sup>10</sup> Leiberman A, Stiller-Timor r.. Thrsiuk A, et al. The effect of adenotonsillectomy on children

Gozal D. Sleep-disordered breathing and school performance in children. 1998;102:616-620.

<sup>11</sup> Rosenfeld RM, Green RP. Tonsillectomy and adenoidectomy: changing trends. Ann Owl Rhinol Laryngol 1990;99 :187-191.

postoperatore.Hemoragjia mund te jete primare(24h pas operacionit) dhe sekondare(mbi 24h pas kirurgjise).Incidenca e hemoragiise primare eshte 0.2-2.2% ndersa per hemoragjine sekondare incidenca eshte 0.1 me 3%.Menaxhimi i hemoragiise kerkon nje tjeter nderhyrje ose observim te pacientit.

Ne nje studim te fundit ku moren pjese 17.000 paciente qe kishin pasur hemoragi post tonsilektomi rezultoi se me te riskuar ishin femijet e moshes mbi 12 vjec,seksi mashkull dhe teknikat kirurgjikale qe perdonin nxehesi.Ky studim mbeshtetet nga nje tjeter studim qe tregon superioritetin e teknikave ne te ftohte per incidence me te vogel per hemoragi post tonsilektomi ne krahasim me teknikat qe perdonin nxehesi.Nje studim tjeter i bere ne Gjermani ku moren pjese 16.000 femije dhe te rritur rezultoi se risk te shtuar kishin meshkujt,pacientet me mononukleoze infektive dhe tonsilite rekurrente.Komplikacione te tjera te adenotonsilektomise jane dehidrimi post operator,dhembja,nauzea,te vjellat,edema pulmonare post operatore,stenosa nazofaringeale,insuficencia velofaringeale si dhe komplikacione intraoperatore si trauma te dhembve,te laringut,faringut,palatum mole,laringospazma,aspirim,arrest kardiak,djegie te buzeve,luksacion ose frakture te mandibules.Eshte vene re se komplikacionet ndodhin me shpesh tek femijet qe vuajne nga semundje te tjera si ata me anomali te koagulimit,semundje te zemres,semundje kraniofaciale dhe me te vegjel se 3 vjec.Eshte vleresuar se rreth 1.3% e femijeve kane nevoje per nje rehabilitim te zgjatur dhe rreth 3.9% e tyre kane nevoje per ripranim si pasoje e komplikacioneve.

Komplikacionet e rrugeve te ajrit ndodhin si pasoje e gabimeve mjekesore.Nje studim i kryer se fundi ka vene re femije me problem respiratore si pasoje e adenotonsilektomise.Femijet qe pas adeno&tonsilektomi kane emesis rezistente,ata me sindrome kraniofaciale,ata qe banjojne shume larg nga spitali,ata qe vuajne nga semundje te tjera si diabet mellitus,epilepsi dhe drepanocitoze eshte mire te mbahen ne observim.Sindroma Grisel eshte nje komplikacion i rralle i procedures kirurgjikale ose e infeksionit qe prek traktin e siperm aerodigestiv.Patogeneza hipotetike ka te beje me faktin qe si pasoje e inflamacionit ndodh nje rritje e fleksibilitetit te ligamenteve dhe si pasoje dy vertebrat e para pesojne nje subluksacion,i cili ben qe pasi inflamacioni te kaloje qafa e femijes te mbetet e rrotulluar dhe e fiksuar ne nje ane.Vdekshmeria eshte ne shkallen 1 me 16.000 deri 1 me 35.000,por keto jane te dhena te viteve 1970.Rreth 1/3 e vdekjeve ishin te lidhura me hemoragiine.Nje tjeter studim i bere na jep te dhena se hemoragjite e perseritura mbartin nje risk te rritur per vdekshmeri.

Adenoidektomia mbart edhe ajo risqet e veta.Hemoragji post operatore,insuficience velopalatine,stenoze te nazofaringut,persistence te disfunkcionit te tubave te Eustakit me natyre jatrogjenike, c-spine subluxation si pasoje e hiperextensionit te qafes gjate procedures jane te gjitha komplikacione qe mund te vijne pas adenoidektomise.Kujdes duhet treguar tek femijet me sindrome Dawn per arsyte mundesise per te bere subluksacion atlantoaxial.Nje ankesa qe zgjat deri ne 2 javë pas operacionit eshte era e keqe e frymes.Hemoragjia post adenoidektomi nuk eshte aq e shpeshte.

## **Debate/Polemika**

Akoma ka debate se cila eshte teknika me e mire per tonsilektomine qe do te kishte me pak hemoragji,kosto dhe kohe.Studime te randomizuara dhe kohort tregonje se risk me te larte per hemoragji post tonsilektomi kane tonsilektomite e nxehta ne krahasim me ato te ftohta.Nje studim tregon se nuk ka ndryshim sinjifikant midis teknikes qe perdor elektroauter me ate qe perdor cobaltion.

Antibiotiket perdoren ne rutine ne periudhen perioperatore.Ne nje studim te bere ne lidhje me perdorimin e tyre rezultoi se ato nuk ndikojne fare ne reduktimin e dhimbjes post operatore,ne reduktimin e perdorimit te analgjezikeve apo ne permiresimin e shpejt te gjendjes.Ato ndikojne ne rritjen e rezistences ndaj antibiotikeve dhe ne rrezikun per reaksione alergjike.Rekomandohet nderprerja e perdorimit ne menyre rutine te antibiotikeve ne periudhen perioperatore.

Nje meta-analize demostroi nje rritje te rrezikut per hemoragji post tonsilektomi ne rastin kur si analgjezik perdoret aspirina dhe kjo nuk ndodh per antiinflamatoret e tjere jo steroid si ibuprofen,diclofenac etj.

Per sa i perket infiltrimit lokal te submukozez me anestezi perpara apo pas excisionit eshte vene re se, nuk ka ndikim fare ne dhembjen e pacientit pas tonsilektomise.

Per disa dekada eshte vene re qe administrimi i nje doze dexamethasone tek femijet gjate operacionit do te redukoje nauzen dhe te vjellat ne periudhen post operatore.Studimet e para ne lidhje me perdorimin e tij shfaqnin nje rritje te riskut per hemoragji por nga rishikimet e bera me pas kjo gje u hodh poshte.Nje rishikim i bere nga Cochrane rezultoi se perdorimi i dexamethasone con ne nje perparim me te shpejt drejt fillimit te dietes se plote tek femijet pas tonsilektomise. Ne udhezuesit e praktikes klinike me te fundit miratohet perdorimi i nje doze dexamethasone tek femijet qe do ti neneshtrohen tonsilektomise.<sup>12</sup>

## **Udherrefyesi i praktikes klinike**

Ne vitin 2010 eshte publikuar udherrefyesi i praktikes klinike per tonsilektomine ne femijet 1-18 vjec pa patologji te tjera si diabet mellitus,semundje kardipulmonare,crregullime kraniofaciale,semundje kongenitale te kokes dhe qafes,koagulopati apo hemoglobinopati.Qellimi ishte te drejtonin mjeket drejt perzgjedhjes se femijeve qe do kryenin tonsilektomi dhe do kishin perfitime te mira.

---

<sup>12</sup> Cullen KA. Hall MJ, Golosinski A Ambulatory surgery in the United States, 2006. *Natl Health Stat Report* 2009;1-25.

Rosenfeld RM, Green RP. Tonsillectomy and adenoidectomy: changing trends. *Ann Owl Rhinol Laryngol* 1990;99 :187-191.

Ali NJ, Pitson DJ, Stradling JR Snoring,sleep disturbance and behaviour in 4-5 year olds. *Arch Dis Child* 1993;68:360-366.

**Tab.2 Paraqitja e permblehdhur e udherrefyesit të praktikes klinike 2010**

1.	Observim per infeksione rekurente tonsilare nese:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• &lt;7 episode ne vitin e kaluar ose</li> <li>• &lt;5 episode ne 2 vitet e kaluar ose</li> <li>• &lt;3 episode ne 3 vitet e kaluar</li> </ul>
2.	Tonsilektomi per infeksionet si me poshte :
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• &gt;7 episode ne vitin e kaluar ose &gt;5 episode ne 2 vitet e kaluara ose &gt;3 episode ne 3 vitet e kaluar</li> <li>• me te dhena te dokumentuara per cdo dhimbje fytje qe ka pasur temperature &gt;38.3 C,adenopati cervikale,eksudat peritonsilar,test pozitiv per grup A beta hemolitik streptokok</li> </ul>
3.	Tonsilektomia mund te konsiderohet tek femijet qe kane:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• alergji/intolerance nga shume antibiotike</li> <li>• ESFA</li> <li>• APT</li> </ul>
4.	Ne rastin e tonsilektomise per CFGJ duhet te merren te dhena te kujdeseshme nga familjaret per problem ne rritje,prapambetje ne shkolle,rrregullime te sjelljes dhe enuresis nocturne
5.	Ne femijet me polisomnografi jonormale dhe me tonsil hipertrofike,tonsilektomia mundeson permiresim te shendetit te femijes
6.	CFGJ mund te persistojne edhe pas adeno&tonsilektomise.Ne kete rast duhet kerkuar per patologji te tjera.
7.	Nje doze e vetme intravenoze e

	dexamethasone gjate tonsilektomise permireson dukshem nauzene dhe te vjellat postoperatorore
<b>8.</b>	Femijet qe do i nenshtrohen tonsilektomise nuk kane nevoje per antibiotik perioperator.
<b>9.</b>	Mjeket duhet te kujdesen qe pacientit ti pakesoj dhimbjet duke i dhene AIJS
<b>10.</b>	Mjeket duhet te vleresojne cdo vit rastet e tyre me hemoragji primare dhe sekondare post tonsilektomi

**Tab.5 Udherrefyesi i praktikes klinike 2010 per Tonsilektomi dhe CFGJ**

<b>1.</b>	Tonsilat hipertrofike ndikojne ne CFGJ
<b>2.</b>	CFGJ eshte shpesh multifaktorial
<b>3.</b>	Obeziteti luan nje rol te madh nr CFGJ
<b>4.</b>	Polisomnografia konsiderohet si standart i arte per diagnozen e CFGJ.
<b>5.</b>	Tonsilektomia eshte efektive ne 60-70% te femijeve me CFGJ dhe hipertrofi tonsilare.
<b>6.</b>	Tonsilektomia eshte efektive vetem ne 10- 25% te femijeve obez qe vuajne me CFGJ.
<b>7.</b>	Specialistet e shendetit keshillojne qe tonsilektomia nuk eshte kurative ne te gjitha rastet me CFGJ tek femijet obez.

## Konkluzione

Tek femijet e zgjedhur ne menyre korrekte adeno&tonsilektomia mund te ul rastet e infeksioneve,te zgjidh ose te permiresoj SDB dhe komplikacionet e saj dhe te permiresoj kualitetin e jetes.Megjithese pyetjet dhe debatet do vazhdojne,ne kete teme u perpoqem te formonim nje skelet rrith trajtimit te kesaj ceshtje te rendesishme dhe kritike.

### Pikat kryesore

- Semundjet adenotonsilare shfaqen tek femijet me infeksione rekurrente te grykeve dhe CFGJ.Se fundi indikacioni kryesor per adeno&tonsilektomi eshte CFGJ.
- Furnizimi me gjak i tonsilave palatine behet nepermjet degeve te a.karotide externe:a ascendente faringeale,a.ascendente palatine dhe dege nga a.linguale dhe a.faciale.
- Afersisht 30% e tonsilofaringiteve shkaktohen nga SBHA.Patogeni te tjere qe akuzohen jane grup C beta hemolitik streptokoku,N.gonorrea,C.difteria,C.pneumonie dhe M.pneumonie
- Infeksionet akute duhet te menaxhohen duke bere me pare kulturen e fytit dhe titrin e antikorpeve antistreptolizina O.Fatmiresisht streptokoket e grupit A vazhdojne te jene te ndjeshem ndaj penicilines,e cila eshte antibiotiku i linjes se pare.
- Megjithese polisomnografia eshte standarti i arte per vendosjen e diagnozes se CFGJ,ajo nuk eshte e domosdoshme qe te kryhet tek cdo femije.Tek disa femije qe kane shenja dhe simptoma te qarta per CFGJ duhet te kryhet adeno&tonsilektomi pa pasur nevoje te kryhet polisomnografia.
- Akademia Amerikane e Otolaringologeve ne vitin 2010 ka nxjerr nje udherrefyes te praktikes klinike per indikimet se kur duhet te kryhet tonsilektomia.Dy indikacionet me te shpeshta ishin CFGJ dhe tonsilitet rekurrente.
- Megjithese shumica e njerezve mendojne se tonsilektomia eshte nder operacionet me te lehta,ajo eshte nje procedure kirurgjikale e rendesishme qe ka nje potencial te madh per komplikacione kirurgjikale dhe te

**anestezise. Adeno&tonsilektomia ka mundesuar reduktimin e infekcioneve te grykeve, permiresuar CFGJ dhe cilesine e jetes se shume pacienteve.**

## LITERATURA

1. Mitchell RB, Kelly J, life in children with sleep-disordered breathing. *Int J Pediatr Otorhinolaryngol* 2006;70:395-406.
2. Leiberman A, Stiller-Timor r.. Thrasiuik A, et al. lhe effect of adenotonsillectomy on children  
*Owrhinolaryngol* 2006;70:1675-1682.
3. Gozal D. Sleep-disordered breathing and school performance in children.  
1998;102:616-620.
4. Stewart MG, Friedman EM, Sulek M, et al. Quality of life and health status in pediatric tonsil and adenoid disease. *An:h Owlaryngol Head Neck Surg* 2000;126:45-48.
5. Cullen KA. Hall MJ, Golosinskiy A Ambulatory surgery in the United States, 2006. *Nat! Health Stat Report* 2009:1-25.
6. Derkay CS. Pediatric otolaryngology procedures in the United States: 1977-1987. *IntiPediatrOtmhinolaryngol* 1993;25:1-12.
7. Rosenfeld RM, Green RP. Tonsillectomy and adenoidectomy: changing trends. *Ann Owl Rhinol Laryngol* 1990;99 :187-191.
8. Erickson BK. Larson DR. St Sauver JL. et al. Changes in incidence and indications of tonsillectomy and adenotonsillectomy, 1970- 2005. *Owlaryngol Head Neck Surg* 2009;140:894-901.
9. Ali NJ, Pitson DJ, Stradling JR Snoring,sleep disturbance and behaviour in 4-5 year olds. *A''h Dis Child* 1993;68:360-366.
10. Mattila PS, Thhkokallio 0, Tarkkanen J, et al. Causes of tonsil- lar disease and

frequency of tonsillectomy operations. *An:h Owlaryngol Head Neck Surg* 2001;127:37-44.

11. Guilleminault C, Lee JH, Chan A Pediatric obstructive sleep apnea syndrome. *An:h Pediatr Adolesc Med* 2005;159:775-785.
12. Goerlinger GC, Vidic B. The embryogenesis and anatomy of Waldeyer's ring. *Owlaryngol Clin NorthAm* 1987;20:207-217.
13. Ohtsuka K, Thmita H, Murakami G. Anatomy of the tonsillar bed: topographical relationship between the palatine tonsil and the lingual branch of the glossopharyngeal nerve.&m *Owlaryngol Suf* 11112002:99-109 .
14. Ceylan S, Salman S, Bora F. Anomaly of the internal carotid artery detected during tonsillectomy. *J Craniofac Surg* 2010;21: 1638-1639.
15. Nave H, Gebert A, Pabst R. Morphology and immunology of the human palatine tonsil. *Anat Embryo! (Berl)* 2001;204:367-373.
16. van Kempen MJ, Rijkers Gr, Van Cauwenberge PB. The immune response in adenoids and tonsils. *Int An:h Allergy Immunol* 2000;122:8-19.
17. Richtsmeier WJ. Human interferon production in tonsil and adenoid tissue cultures. *Am J Owlaryngol* 1983;4:325-333.